

UDHËZUES PËR PROMOVIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E KAPACITETEVE NË NIVEL LOKAL PËR TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE DHE KONTROLL MBI PUNËN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE LOKALE



UDHËZUES PËR PROMOVIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E KAPACITETEVE NË NIVEL LOKAL PËR TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE DHE KONTROLL MBI PUNËN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE LOKALE

Shkup, maj 2020



Projekti është financuar
nga Bashkimi Evropian

Organizatat qytetare dhe mediat në kontrollin
mbi punën e ndërmarrjeve publike më Rajonin
Planor të Pollogut



UDHËZUES PËR PROMOVIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E KAPACITETEVE NË NIVEL LOKAL PËR TRANSPARENÇË, LLOGARIDHËNIE DHE KONTROLL MBI PUNËN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE LOKALE

Instituti për Kërkime Strategjike dhe Edukim

www.isie.org.mk

Lektoroi

Liljana Jovanovska

Shtypi

Kjo broshurë u përgatit me ndihmën e një granti të akorduar përmes projektit "Përforcimi i integritetit dhe zvogëlimi i korrupsionit në biznes-sektorin shtetëror dhe privat" i implementuar nga Qendra për Komunikime Civile, Shoqata Connect dhe Shoqata e Këshilltarëve Tatimore, kurse në kuadër të projektit "Organizatrat civile dhe mediat në kontrollin e punës së ndërmarrjeve publike në rajonin planor të Pollogut". Përmbajtja e botimit është përgjegjësia e vetme e Institutit për Kërkim Strategjik dhe Edukim - IKSE dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Rreth projektit

Projekti "Organizatat civile dhe mediat në kontrollin e punës së ndërmarrjeve publike në rajonin planor të Pollogut" zbatohet nga Instituti për Kërkim Strategjik dhe Edukim - IKSE nga Shkupi në periudhën nëntor 2019 - nëntor 2020. Ky botim është përgatitur në kuadër të këtij projekti me ndihmën e një granti të dhënë përmes projektit " Përforsimi i integritetit dhe zvogëlimi i korrupsionit në sektorin e biznesit publik dhe privat", i financuar nga Bashkimi Evropian, kurse i implementuar nga Qendra për komunikime qytetare në partneritet me Shoqatën Connect dhe Shoqatën e këshilltarëve tatimor.

Qëllimi i projektit është të inkurajojë përdorimin e mekanizmave që mundësojnë kontroll, transparencë dhe llogaridhënie të ndërmarrjeve publike lokale në Rajonin Planor të Pollogut, nga vetë ndërmarrjet publike, këshillat komunalë, media lokale dhe aktivistët dhe organizatat qytetare lokale.

Në kuadër të projektit, IKSE përgatiti këtë Udhëzues, i cili është në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Qëllimi i udhëzuesit është që të jetë një mjet për anëtarët e këshillave komunalë, si dhe për organizatat civile dhe mediat në vendin tonë dhe është në funksion të fitimit të njohurive themelore për të drejtat dhe detyrimet e tyre brenda kornizës institucionale që ka të bëjë me transparencë më të madhe të ndërmarrjeve publike.

Përmes aktiviteteve të këtij projekti, përfshirë edhe përgatitjen e këtij studimi, dëshirojmë të nxisim interesin e qytetarëve për të realizuar të drejtat e tyre në nivelin lokal, sidomos sa i përket rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së ndërmarrjeve publike lokale.

HYRJJE

Kontrollimi i shpenzimeve të parave publike nga personat juridikë që kryejnë veprimtari publike, gjegjësisht ndërmarrjet publike, është një sfidë e veçantë në çdo vend. Hulumtimet, përfshirë hulumtimet e mëparshme nga Qendra për komunikime qytetare dhe Instituti për Kërkime Strategjike dhe Edukim, tregojnë një nivel mesatar të pakënaqshëm të transparencës dhe llogaridhënies së subjekteve publike-juridike.

Kontrolli mbi shpenzimin e parave publike mund të institucionalizohet (brenda procedurave të sistemit). Ky kontroll konsiston në kontrollin mbikëqyrës të funksionimit të ndërmarrjeve publike nga vetë themeluesit e tyre. Përkatësisht, përveç organeve të ndërmarrjeve publike, siç është bordi i drejtuesve dhe bordi mbikëqyrës, themeluesi i ndërmarrjes kontrollon punën e ndërmarrjes publike në përputhje me nenin 11 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, i cili në rastin e ndërmarrjeve publike lokale është Këshilli Komunal.

Për më tepër, kontrolli mbi shpenzimin e parave publike mund të ushtrohet edhe nga sektori i shoqërisë civile, përfshirë këtu organizatat e shoqërisë civile dhe aktivistët e shoqërisë civile, si dhe mediat. Përveç kësaj, media, përmes formave të gazetarisë hulumtuese të bazuar në fakte, luan një rol të veçantë në monitorimin dhe publikim e veprimtarive të paligjshme.

Këshillat e komunave, përkatësisht Këshilli i qytetit të Shkupit, janë organe përfaqësuese ku qytetarët, përmes këshilltarëve të zgjedhur direkt i realizojnë të drejtat e tyre. Një segment i rëndësishëm i të drejtave që u takojnë qytetarëve në nivelin lokal janë të drejtat për të përdorur shërbime publike efikase dhe ekonomike dhe aktivitete publike. Mekanizmi kryesor për operacionalizimin e veprimtarive publike dhe shërbimeve publike në nivel lokal janë ndërmarrjet publike lokale. Në përputhje me rregulloret ligjore, të shpjeguara më poshtë në tekst, themeluesi i ndërmarrjeve publike lokale janë këshillat e njësive të vetëqeverisjes lokale. Në këtë kuptim, këshillat e njësive të vetëqeverisjes lokale luajnë një rol kryesor kontrolli për 1) mënyrën e realizimit të veprimtarive dhe

shërbimeve publike dhe 2) mënyrën e vendosjes, punës dhe funksionimit të ndërmarrjeve publike lokale.

Në këtë kuptim, qëllimi i këtij Udhëzuesi është të mundësojë rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të këshillave, dhe në drejtim të përdorimit efikas të të drejtave dhe detyrimeve të tyre të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Duke marrë parasysh faktin se këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale është një organ përfaqësues, ku nuk kërkohen kualifikime dhe kompetenca profesionale për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit, ky Udhëzues synon të plotësojë njohuritë e anëtarëve të këshillit për mjetet dhe mekanizmat të cilët ua sigurojnë ligjet, dhe me qëllim të zbatimit të kontrollit efektiv mbi punën e ndërmarrjeve publike lokale. Për më tepër, duke pasur parasysh faktin se anëtarët e këshillit janë përfaqësues të qytetarëve, pjesa e fundit e Udhëzuesit paraqet modalitetet themelore të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal dhe format e krijimit të lidhjes midis qytetarëve dhe këshillave komunalë, gjegjësisht mes qytetarëve dhe pushtetit më të gjërë.

1. Pozicioni i Këshillit Komunal, gjegjësisht qytetit të Shkupit në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale gjatë ushtrimit të pushtetit lokal.

Në përputhje me nenin 32 të Ligjit për vetëqeverisje lokale¹, Këshilli është një organ përfaqësues i qytetarëve që vendos brenda kompetencave të komunës.

Këshilli përbëhet nga përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Numri i anëtarëve të Këshillit përcaktohet në varësi të numrit të banorëve në komunë dhe nuk mund të jetë më pak se nëntë ose më shumë se 33 anëtarë.

Kompetencat e Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes lokale rregullohen në nenin 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Përkatësisht, brenda kompetencave të Këshillit, përfshihen këto: (1) miraton statutin e komunës dhe rregulloret e tjera; (2) miraton buxhetin e komunës dhe llogarinë vjetore të komunës; (3) përcakton shumën e burimeve të veta të të ardhurave për financim të komunës, brenda kornizës së përcaktuar me ligj; (4) krijon shërbime publike nën kompetencën e komunës dhe mbikëqyr punën e tyre; (5) emëron anëtarët në bordet drejtuese të shërbimeve publike, të cilat i krijon; (6) miraton programe për punë dhe plane financiare për financimin e shërbimeve publike të krijuara nga komuna; (7) miraton raporte për realizimin e buxhetit dhe llogarinë vjetore të komunës; (8) vendos për dhënien e lejeve për kryerjen e veprimtarisë me interes publik me rëndësi lokale, në përputhje me ligjin; (10) miraton raporte të punës dhe llogaritë vjetore të shërbimeve publike, të cilët i ka themeluar komuna; (11) vendos për mënyrën e pronësisë me pronën e komunës; (12) vendos për mënyrën e realizimit të kontrollit financiar të buxhetit të komunës, në përputhje me ligjin; (13) zgjedh personin i cili do të udhëheq me njësinë rajonale të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përputhje me ligjin; (14) shqyrton dhe miraton raportin vjetor për sigurinë publike

¹ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 05/2002.

të rajonit të komunës, të cilin e parashtron deri te ministri i punëve të brendshme dhe avokati i popullit; (15) mund të jep rekomandime personit udhëheqës të njesisë rajonale të Ministrisë së Punëve të Brendshme në fushën e sigurisë publike dhe sigurisë në trafik dhe (16) të kryej edhe veprimtari të tjera të vërtetuara me ligj.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale (LVL): Fillimi i procedurës për kryerjen e kontrollit mbi veprimtarinë materiale dhe financiare të ndërmarrjes publike

Në përputhje me nenin 36, paragrafi (2) në rast se Këshilli nuk e miraton raportin e përmendur në nenin 36, paragrafi (1) p. 9, kurse këto janë raportet për punën dhe llogaritë vjetore të shërbimeve publike, të cilat u krijuan nga komuna, Këshilli mund të fillojë një procedurë për kryerjen e kontrollit mbi punën materiale dhe financiare përpara organit kompetent mbikëqyrës. Përmes këtij mekanizmi, Këshilli mund të mbikëqyrë drejtpërdrejt punën e ndërmarrjes publike.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale (LVL): Krijimi i komisioneve të përhershme dhe të përkohshme

Në përputhje me nenin 32, paragrafi (2) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Këshilli, nga përbërja e tij, mund të krijojë komisione të përhershme dhe të përkohshme për shqyrtimin e çështjeve dhe përcaktimin e propozimeve në një fushë të caktuar. Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve rregullohen me statut. Në këtë mënyrë, përmes specializimit të këtyre komisioneve, do të jetë e mundur të forcohen kapacitetet njerëzore të anëtarëve të këshillit, për nevojat për kontroll financiar dhe juridike të punës së ndërmarrjeve publike lokale.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale (LVL): Thirrja e seancës së Këshillit me kërkesë të këshilltarëve

Në përputhje me nenin 39 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, seancat e Këshillit thirren sipas nevojës, por të paktën një herë në tre muaj. Seancat thirren nga Kryetari i Këshillit me iniciativën e tij, me kërkesë të Kryetarit të Komunës ose me kërkesë të të paktën 1/4 e anëtarëve të Këshillit, jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës. Nëse brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, kryetari nuk e thërret mbledhjen/seancën e Këshillit, anëtarët e Këshillit mbledhen dhe zgjedhin një kryetar për atë seancë ose mbledhje.

Neni 40 i Ligjit për vetëqeverisje lokale rregullon çështjen e thirrjes së seancës së jashtëzakonshme të Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes lokale. Në harmoni me nenin 41 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Këshilli mund të funksionojë nëse shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit janë të pranishëm në seancë. Këshilli vendos me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj dhe statut.

Sipas nenit 47 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, kryetari zgjedhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit, me një mandat katërvjeçar. Kandidati që ka marrë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit zgjedhet Kryetar i Këshillit. Sipas nenit 48 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit: (1) thërret dhe kryeson seancat e Këshillit; (2) kujdeset për organizimin dhe punën e Këshillit dhe (3) nënshkruan rregulloret e miratuara nga Këshilli dhe brenda një afati treditor nga dita e miratimit të tyre, ia paraqet kryetarit të komunës për publikim.

Pikërisht këto dispozita lejojnë këshilltarët që, sa herë që bëhet fjalë për një çështje të rëndësishme me interes për veprimtaritë publike, dhe natyrisht kur bëhet fjalë edhe për funksionimin e ndërmarrjeve publike lokale për të cilat Këshilli është autorizuar, të kërkojnë mbajtjen e një seance të veçantë (të jashtëzakonshme) të Këshillit.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale (LVL): E drejta e anëtarëve të Këshillit për të dhënë iniciativa, propozime dhe për t'i parashtruar pyetje kryetarit

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë dhe detyrë të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në punën e Këshillit dhe komisionet e tij të përhershme ose të përkohshme (neni 43 i Ligjit). Për më tepër, e njëjta dispozitë përcakton që anëtarët kanë të drejtë të japin iniciativa dhe propozime në seancën e Këshillit dhe t'i bëjnë pyetje Kryetarit të Komunës. Gjithashtu, neni 43, paragrafi (3) përcakton që një anëtar i Këshillit nuk mund të mbahet përgjegjës penalisht ose të arrestohet për shprehjen e një mendimi ose votimi në Këshill.

Ky mekanizëm u mundëson këshilltarëve që për çështjet për të cilat, sipas Ligjit për ndërmarrje publike, kryetari i komunës është i autorizuar, të ndikojnë tërthorazi në krijimin e një kornize të përbashkët për kontrollin dhe mbikëqyrjen e punës së ndërmarrjeve publike lokale. Një çështje e tillë, për shembull, është zgjedhja e drejtorit të një ndërmarrje publike lokale, siç edhe shpjegohet në pjesën e dytë të këtij Udhëzuesi.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale (LVL): Transparenca e seancave të Këshillit të Komunës, gjegjësisht Këshillit të qytetit të Shkupit

Sa i përket pjesës së punës publike dhe transparente të Këshillit, dispozita e nenit 42 të Ligjit për vetëqeverisje lokale është veçanërisht e rëndësishme. Përkatësisht, në përputhje me këtë dispozitë, seancat e Këshillit janë publike, ndërsa përjashtimi i pranisë së publikut nga seanca vendoset nëse ka arsye të justifikuara të përcaktuara me statut, me një shumicë prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit. Për më tepër, ligji përcakton që prania e publikut nuk mund të përjashtohet nga debati i buxhetit komunal, llogarisë vjetore të buxhetit dhe planeve urbane.

Kjo dispozitë u lejon këshilltarëve që, përmes publikut të pranishëm, si aleat i tyre, të sigurojnë një shkallë më të lartë të transparencës në procesin e vendimmarrjes, por edhe të ruajnë interesin publik.

**Mekanizmi i kontrollit në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale (LVL):
Themelimi i Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve**

Në nenin 56 të Ligjit për vetëqeverisje lokale parashikohet edhe *Këshilli i Mbrojtjes së Konsumatorëve*. Përkatësisht, për shqyrtimin e çështjeve dhe përcaktimin e propozimeve që i referohen cilësisë së shërbimeve publike të komunës, Këshilli mund të krijojë Këshillin për Mbrojtjen e Konsumatorit, i përbërë nga përfaqësues të grupeve më të mëdha të shfrytëzuesve të shërbimeve publike. Konsiderojmë se Këshilli i këtillë mund të luajë një rol kyç në mbrojtjen e konsumatorëve, dmth qytetarëve kur përdorin shërbimet e ndërmarrjeve publike. Në këtë drejtim, këshilltarët mund të përdorin këtë mekanizëm, në mënyrë që të kontrollojnë në mënyrë efektive shërbimet e ofruara nga ndërmarrjet publike lokale.

2. Mekanizmat të cilët janë në dispozicion të këshilltarëve në Këshillat e komunave dhe në Qytetin e Shkupit për kontrollin e punës së ndërmarrjeve publike lokale në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike.

Ligji themelor që rregullon themelimin, funksionimin dhe strukturën e ndërmarrjeve publike është Ligji për ndërmarrjet publike.²

Në përputhje me dispozitat ligjore të përfshira në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, ndërmarrjet publike mund të organizohen për kryerjen e veprimtarive me interes publik, dhe në përputhje me nenin 2) paragrafi (1) të këtij ligji, si veprimtari me interes publik përcaktohen veprimtaritë ose disa aktivitet të veçanta me të cilat realizohet interesi publik.

Ligji për vetëqeverisje lokale, poashtu përmban një përkufizim të termit "shërbim publik" (neni 2 paragrafi (1), p.10), që me shërbime publike nënkuptohen organizata jofitimprurëse për kryerjen e shërbimeve publike (ndërmarrjet publike dhe institucionet publike), të cilat kryejnë një veprimtari me interes publik me rëndësi lokale. Në nenin 2, paragrafi (1) pika 11 si një shërbim publik përcaktohet kryerja e veprimtarive me interes publik me rëndësi lokale për përdoruesit.

Në përputhje me Ligjin e vetëqeverisjes lokale, neni 24 përcakton mënyrën e kryerjes së kompetencave. Për të kryer detyrat (kompetencat) e tyre, komunat mund të krijojnë shërbime publike në përputhje me Ligjin. Komuna mund të delegojë kryerjen e veprimtarive të caktuara me interes publik me rëndësi lokale personave të tjerë juridikë ose fizikë, në bazë të marrëveshjes për kryerjen e punëve me interes publik, në përputhje me ligjin.

² "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/96, 6/2002, b 40/2003, 49/2006, 22/2007, 83/2009, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/16, 61/15 dhe 39/16

Në kryerjen e aktiviteteve me interes publik, duhet të respektohen këto parime: siguria në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësia dhe cilësia e shërbimit, transparenca, disponueshmëria dhe shërbimi universal, mbrojtja e klientëve dhe konsumatorëve.

Në bazë të paragrafit (2) të nenit 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike, themeluesit e ndërmarrjeve publike mund të jenë njësitë e vetëqeverisjes lokale, përkatësisht komunat dhe Qyteti i Shkupit. Paragrafi (3) i nenit 1 i Ligjit për ndërmarrjet publike përcakton që ndërmarrjet publike në emër të komunës i themelon Këshilli Komunal, dhe kurse ato në emër të qytetit të Shkupit themelohen nga Këshilli i qytetit të Shkupit.

Dispozita e nenit 1, paragrafi (3) i Ligjit për ndërmarrjet publike, është burimi i kompetencës, sipas të cilit përcaktohet roli kryesor i këshillave komunalë, d.m.th., Këshilli i qytetit të Shkupit për sa i përket funksionimit të përgjithshëm të këtyre ndërmarrjeve. Në këtë kuptim, kur analizohet hollësisht Ligji për ndërmarrjet publike, mund të kutohet se këshilltarët individualisht dhe këshilli si organ kolektiv luajnë një rol kyç kontrolli. Në këtë mënyrë, ata pritet të jenë aktorë aktivë në këtë proces, të paktën sipas dispozitave ligjore. Në përputhje me qëllimin dhe nevojën e këtij Udhëzuesi, i cili ka për qëllim përforcimin dhe përmirësimin e njohurive të anëtarëve të këshillave, të gjitha mekanizmat e veçantë të kontrollit që janë në dispozicion të anëtarëve të këshillave janë treguar veç e veç.

Në përputhje me nenin 13 të Ligjit për ndërmarrjet publike, ndërmarrja publike është e organizuar në mënyrë që veprimtaria, për shkak të së cilës është themeluar, të kryhet në atë mënyrë që siguron: (1) unitet tekniko-teknologjik dhe ekonomik të sistemit; (2) efikasitet dhe transparencë në punë; (3) zhvillim dhe harmonizim të zhvillimit të vet me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik; (4) mbrojtje dhe promovim të mallrave me interes të përgjithshëm; (5) plotësim të përhershëm, të rregullt dhe cilësor të nevojave të konsumatorëve për produktet dhe shërbimet dhe (6) pavarësi dhe barazi brenda sistemit dhe lidhshmëri funksionale me sistemet e tjera në vend dhe botë.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me LVL: Këshilltarët e njësisë së vetëqeverisjes lokale, përmes Këshillit të njësisë, kryejnë kontroll mbi aktet e ndërmarrjes publike. Ky kontroll fillon në momentin e themelimit të ndërmarrjes publike, gjegjësisht me miratimin e aktit për themelimin e ndërmarrjes publike.

Ndërmarrja publike themelohet me akte themeluese, të cilat sipas nenit 10 të Ligjit për ndërmarrjet publike rregullojnë këto çështje:

- veprimtarinë;
- ndërmarrjen dhe selinë;
- shumën e fondeve për themelim dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- organizimin e ndërmarrjes publike;
- mënyrën e zbatimit të vendimeve të organeve të ndërmarrjes publike;
- përgjegjësinë e ndërmarrjes publike për detyrimet në transaksionet ligjore me palët e treta dhe afatin e miratimit të statutit dhe emërimin e organeve të ndërmarrjes publike, si dhe
- emërimin e një personi për të udhëhequr punët e ndërmarrjes deri në konstituimin e saj.

Dispozita e nenit 10 të Ligjit për ndërmarrjet publike, dhe në lidhje me nenin 9 të të njëjtit Ligj ("Këshilli Komunal dhe Këshilli i qytetit të Shkupit, për krijimin e një ndërmarrje publike miraton një akt për themelimin e një ndërmarrje publike") u mundëson anëtarëve të këshillave të njësisë së vetëqeverisjes lokale, madje edhe në fazën fillestare të themelimit të ndërmarrjes publike që në mënyrë aktive të përfshihen përmes këtij mekanizmi kontrolli. Në këtë mënyrë, anëtarët e këshillave marrin pjesë drejtpërdrejt dhe personalisht në përcaktimin e përmbajtjes së akteve të themelimit të ndërmarrjeve publike dhe në eliminimin përfundimtar të paligjshmërive në këtë fazë. Kjo fazë, pra përgatitja e akteve për themelimin e ndërmarrjes, kërkon nga këshilltari njohuri më të gjera si për ligjin, ashtu edhe për operacionet financiare, proceset e përzgjedhjes së stafit dhe burimeve njerëzore, menaxhimit dhe të ngjashme. Gjithashtu, për arsye praktike, kërkohet një nivel i caktuar njohurish për rregullat nomoteknike, të nevojshme për përgatitjen e këtyre akteve.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me LVL: Kontrolli mbi aktet e ndërmarrjes publike kryhet edhe gjatë funksionimit të ndërmarrjes publike.

Në bazë të nenit 11 të Ligjit për ndërmarrjet publike, themeluesi i ndërmarrjes publike, përkatësisht Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale, jep pëlqimin për aktet e mëposhtme:

- Statutin e ndërmarrjes publike;
- Ndryshimet e statutit;
- Aktin për përdorimin e fondeve të realizuara me punën e ndërmarrjes publike dhe mbulimin e humbjeve;
- Aktin e detyrimeve të ndërmarrjes publike;
- Aktin që përcakton çmimet e produkteve dhe shërbimeve që ndërmarrja publike i shet dhe kryen për klientët nëse çmimet e tilla nuk i nënshtrohen rregullimit nga një organ rregullator i pavarur
- Llogarinë dhe raportin vjetor për punën e ndërmarrjes publike dhe
- Programin vjetor të investimeve të harmonizuar me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Kjo dispozitë përcakton një sërë veprimesh të përgatitura nga ndërmarrja publike gjatë punës së saj dhe kanë të bëjë me operacionalizimin dhe zbatimin praktik të aktiviteteve dhe politikave. Në mënyrë që aktet e përcaktuara të bëhen ligjërisht të detyrueshme, ato duhet të aprovohen nga Këshilli Komunal, d.m.th. nga Këshilli i qytetit të Shkupit. Këto janë akte që rregullojnë çështje veçanërisht të rëndësishme dhe për këtë arsye edhe në këtë situatë, këshilltarit i kërkohet të zotërojë njohuri të caktuara më të gjera sa i përket drejtësisë, punës financiare, rregullave të kontabilitetit, rregullave të taksave dhe të ngjashme. Dispozitat e nenit 11 të Ligjit për ndërmarrjet publike, anëtarëve të Këshillit Komunal, përkatësisht anëtarëve të Këshillit të qytetit të Shkupit, u japin mundësinë që të përfshihen më drejtpërdrejt dhe personalisht në krijimin e aktiviteteve dhe planeve të ardhshme të ndërmarrjes publike. Këtu do të përmendim veçanërisht Programin vjetor të investimeve dhe Aktin për përdorimin e fondeve të realizuara me punën e ndërmarrjes publike dhe mbulimin e humbjeve. Pikërisht ky mekanizëm kontrolli

lejon këshilltarët të përmbushin angazhimet e tyre të cilët ata u kanë paraqitur votuesve të tyre në lidhje me politikat lokale me interes publik që duhet të ndjekin. Këshilltarët e këshillave komunalë dhe këshilltarët e Këshillit të qytetit të Shkupit duhet të mos harrojnë se ata përcaktojnë udhëzimet dhe përparësitë me interes publik lokal, kurse ndërmarrjet publike lokale janë ato që i realizojnë dhe praktikisht zbatojnë projektet me interes publik lokal.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me LVL: Parimi i transparencës dhe llogaridhënies në marrëdhëniet financiare

Një nga postulatet themelore të Ligjit për ndërmarrjet publike është parimi i transparencës dhe llogaridhënies së marrëdhënieve financiare. Përkatësisht, neni 7 i Ligjit për ndërmarrjet publike përcakton që ndërmarrjet publike dhe shoqëritë që kryejnë veprimtari me interes publik, kontabilitetin, përgatitjen dhe dorëzimin e llogarisë vjetore dhe të raporteve financiare i kryejnë në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe standardet e miratuara ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar të publikuara në "Gazetën Zyrtare".

Mbajtja e librave tregtar (kontabilitetit) dhe ruajtja e tyre, mbajtja e dokumenteve të kontabilitetit, si dhe llogaritë vjetore dhe raportet financiare kryhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare, të cilat i referohen mbajtjes së librave të tregtisë.

Neni 8-b i Ligjit për ndërmarrjet publike përcakton se marrëdhëniet financiare midis shtetit, organeve komunale dhe organeve të qytetit të Shkupit dhe ndërmarrjeve dhe shoqërive publike që kryejnë veprimtari me interes publik duhet të jenë transparente që në mënyrë të qartë të mund të paraqiten:

- fondet që janë në dispozicion të drejtpërdrejtë nga organet e listuara në nenin 8-b për ndërmarrje ose shoqëri të caktuara publike që kryejnë veprimtari me interes publik;

-
- fondet që janë në dispozicion të tërthortë nga organet e përmendura në nenin 8-b të ndërmarrjeve publike, fondeve ose institucioneve financiare dhe
 - mënyra dhe qëllimi për të cilin fondet janë vënë në përdorim.

Në këtë drejtim, do të zbatohet transparenca në marrëdhëniet financiare, veçanërisht në rastet e mëposhtme: a) shlyerja e humbjeve operative; b) sigurimi i kapitalit; c) ndihma e pakthyeshme ose huazimet me kushte më të favorshme; d) sigurimi i përfitimeve financiare duke hequr dorë nga mbledhja e kërkesave; e) heqja dorë nga kthimi normal i fondeve të përdorura dhe f) kompensimi i barrës financiare të parashtruar nga organet shtetërore.

Një mekanizëm i posaçëm i transparencës në lidhje me rregullat e kontabilitetit është dispozita e nenit 8-c të Ligjit për ndërmarrjet publike. Përkatësisht, ndërmarrjet publike, gjegjësisht ndërmarrjet që ndër të tjera kryejnë veprimtari me interes publik janë të detyruar të mbajnë evidencë të veçantë të kontabilitetit në rastet e mëposhtme, nëse:

- 1) kryejnë më shumë aktivitete me interes publik, gjegjësisht aktivitete të tjera;
- 2) kanë të drejta ekskluzive në kryerjen e veprimtarisë me interes publik dhe
- 3) marrin ndihmë shtetërore në çdo formë, përfshirë ndihmë, mbështetje ose kompensim, në lidhje me kryerjen e veprimtarive me interes publik.

Llogaritë speciale duhet të tregojnë qartë:

- a) të ardhurat dhe shpenzimet që rrjedhin nga aktivitete të ndryshme dhe
- b) të dhëna të plota për metodën me të cilën të ardhurat dhe shpenzimet janë caktuar ose alokuar në aktivitete të ndryshme.

Kjo është me rëndësi të veçantë, duke marrë parasysh dispozitën e nenit 11 të Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit Këshilli Komunal, përkatësisht Këshilli i qytetit të Shkupit, miraton llogarinë vjetore të ndërmarrjeve publike. Prandaj, sa më shumë njohuri financiare dhe juridike të kenë këshilltarë, aq më aktivë dhe më të angazhuar do të jenë në qasen e tyre ndaj mbikëqyrjes dhe kontrollit të të dhënave të paraqitura në llogarinë vjetore.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me LVL: Pjesëmarrja në zgjedhjen e organeve të ndërmarrjes publike

Një modalitet i veçantë dhe specifik i kontrollit mbi punën e ndërmarrjes publike dhe politikave dhe objektivave që ajo zbaton është marrëdhënia midis themeluesit të ndërmarrjes publike, dhe në këtë rast është Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe organeve të ndërmarrjeve publike.

Në nenin 16 të Ligjit për ndërmarrjet publike përcaktohen si organe të ndërmarrjes publike: bordi drejtues, bordi mbikëqyrës për kontrollin e aktiviteteve materiale dhe financiare dhe drejtori. Sipas ligjit, bordi drejtues i një ndërmarrje publike përbëhet nga së paku pesë dhe më së shumti 15 anëtarë.

Paragrafi (2) i nenit 17 përcakton që themeluesi emëron, përkatësisht shkarkon përfaqësuesit e bordit drejtues, nga radhët e ekspertëve të afirmuar dhe të njohur në fushën e lëmisë së punës së ndërmarrjes publike, duke marrë parasysh përfaqësimin e duhur dhe të drejtë të anëtarëve të të gjitha komuniteteve.

Në nenin 17 paragrafi (2) rregullohen kushtet specifike që duhet të ketë personi i zgjedhur si anëtar i bordit udhëheqës. Këshilltarët *gjatë vendimmarrjes duhet të kenë njohuri minimale themelore në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, në mënyrë që të vlerësojnë në mënyrë të kënaqshme aftësinë e zgjidhjeve të mundshme të personelit.*

Pjesëmarrja aktive e këshilltarëve në zgjedhjen e anëtarëve të bordit drejtuesi të ndërmarrjes publike është veçanërisht e rëndësishme nëse marrim parasysh kompetencat e bordit udhëheqës. Gjegjësisht, kompetencat e bordit drejtuesi të ndërmarrjes publike përcaktohen në nenin 19 të Ligjit për ndërmarrjet publike dhe ato përfshijnë: (1) miratimin e statutit të ndërmarrjes publike; (2) miratimin e programit për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes publike; (3) miratimin e politikës tregtare, miratimin e llogarisë vjetore dhe raportit për funksionimin e ndërmarrjes publike; (4) vendosjen për përdorimin e fondeve të realizuara me punën e ndërmarrjes publike dhe mbulimin e humbjeve; (5) marrjen e vendimeve për investime; (6) përcaktimin e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve; (7)

vendos për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes publike dhe (8) kryen veprimtari të tjera të përcaktuara me aktin themelues dhe statutin e ndërmarrjes publike. Nga ajo që u tha më lartë mund të konkludojmë se procesi i vendimmarrjes zbatohet në dy faza, faza e parë është brenda ndërmarrjes publike, dhe faza e dytë është faza e miratimit të akteve nga themeluesi i tyre, gjegjësisht Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale . Kjo do të thotë që faza e dytë siguron një mekanizëm të qëndrueshëm kontrolli në duart e këshilltarëve.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me LVL: Parandalimi i konfliktit të interesit të anëtarëve të bordit drejtuesi të ndërmarrjes publike

Dispozitat e posaçme të kontrollit janë të përfshira në nenin 18 të Ligjit për ndërmarrjet publike, dhe i referohen pozicionit të anëtarit të bordit udhëheqës. Përkatësisht, një anëtar i bordit drejtuesi i ndërmarrjes publike mund të mos ketë, personalisht, përmes një pale të tretë ose në çfarëdo baze, interesa në një ndërmarrje ose shoqëri tregtare që është në marrëdhënie tregtare me ndërmarrjen publike, e cila mund të ketë ndonjë ndikim në pavarësinë dhe paanshmërinë e saj në vendimmarrjen e ndërmarrjes publike . Në përputhje me këtë dispozitë, parashikohet një detyrim shtesë për secilin anëtar të bordit drejtues, gjegjësisht drejtorin e ndërmarrjes publike, të paralajmërojë themeluesin për ekzistencën e një interesi të tillë te një ose më shumë anëtarë të bordit drejtues. Në atë mënyrë, përcaktohet roli i këshillit të njësisë së vetëqeverisjes lokale në situatën specifike. Përkatësisht, nga themeluesi i ndërmarrjes publike (Këshilli i Komunës, pra Këshilli i qytetit të Shkupit), edhe në këtë rast, pritet pjesëmarrja aktive e anëtarëve të këshillit, në parandalimin e konflikteve të interesave.

Në këtë kontekst, me interes të veçantë në zbatimin e rolit kontrolluese është edhe neni 21 i Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit një ndërmarrje publike nuk mund t'i jep hua ose garancë huazimi kryetarit ose anëtarit të bordit udhëheqës, kryetarit ose anëtarit të bordit mbikëqyrës ose drejtorit të ndërmarrjes

publike të cilët ata i kanë lidhur me persona të tretë. Detyrimi i ndërmarrë në këtë situatë është i pavlefshëm dhe pa efekt juridik.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me LVL: Dhënia e udhëzimeve të përgjithshme në lidhje me kryerjen e detyrave të caktuara brenda fushveprimit.

Në marrëdhëniet midis bordit drejtuesi të ndërmarrjes publike dhe themeluesit të ndërmarrjes publike, duhet të kihet parasysh se themeluesi i ndërmarrjes publike nuk mund të ndikojë drejtpërdrejt në punën e bordit drejtuesi duke dhënë detyra (autorizime) se çfarë vendimesh të marrin. Sidoqoftë, themeluesi mund t'i referohet dispozitës së nenit 22 të Ligjit për ndërmarrjet publike, me të cilin komuna ose qyteti i Shkupit me propozimin e Ministrit përgjegjës për punët e veprimtarisë përkatëse mund t'i jep bordit drejtues të ndërmarrjes publike udhëzime të përgjithshme në drejtim të kryerjes së aktiviteteve të caktuara brenda fushëveprimit të bordit drejtues të përcaktuar në nenin 19 të Ligjit, të cilin komuna ose qyteti i Shkupit i konsideron me interes për komunën ose qytetin e Shkupit. Udhëzimet e përgjithshme nuk mund të zbatohen për udhëheqjen e përditshëm të ndërmarrjes publike. Këtu mund të shohim që edhe pse, nga njëra anë ekziston një ndarje zyrtare-juridike, Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale mund të marrë pjesë në krijimin e politikave, të ndërmarrjeve publike dhe përmes këtij mekanizmi.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me LVL: Përgjegjësia e organeve të ndërmarrjes publike për dëmin të bërë ndaj ndërmarrjes publike

Në përputhje me nenin 23 të Ligjit, puna e ndërmarrjes publike, e themeluar nga komuna, pra Qyteti i Shkupit, menaxhohet nga një drejtor që e zgjedh, përkatësisht e shkarkon kryetari i komunës, pra Qyteti i Shkupit.

Në nenin 23 përpunohen në mënyrë plotësuese kompetencat e drejtorit. Përkatësisht, drejtori i ndërmarrjes publike (1) siguron zbatimin e vendimeve dhe konkluzioneve të bordit udhëheqës, (2) merr pjesë në zbatimin e bazave të

programit të punës dhe zhvillimit, (3) merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për përdorim dhe posedimin e fondeve dhe përdorimi i fondeve të realizuara me punëne ndërmarrjes publike, (4) harmonizon veprimtarinë tregtare të ndërmarrjes publike dhe (5) kryen veprimtari të tjera ekzekutive në lidhje me funksionimin dhe punën e ndërmarrjes publike të përcaktuar me statut.

Drejtori është i detyruar çdo gjashtë muaj të paraqesë një raport për punën e ndërmarrjes publike deri te bordi udhëheqës, gjegjësisht kryetari i komunës, përkatësisht Qyteti i Shkupit. Në raport, drejtori është i detyruar në veçanti të paraqesë të dhëna për llojin dhe sasinë ose vëllimin e punës së kryer gjatë kryerjes së veprimtarisë së ndërmarrjes publike, si dhe të dhëna për punën financiare. Nëse nga raporti i punës identifikohen mangësi dhe / ose humbje në operacionet financiare, drejtori është i detyruar t'i asgjësoj ato në gjashtë muajt e ardhshëm.

Drejtori i ndërmarrjes publike, të themeluar nga komuna, pra Qyteti i Shkupit, është përgjegjës për punën e tij para kryetarit të komunës, përkatësisht qytetit të Shkupit. Drejtori lidh një marrëveshje me Kryetarin e Komunës, gjegjësisht Qytetin e Shkupit për rregullimin e marrëdhënieve me ndërmarrjen publike, në të cilën marrëveshje të drejtat, përgjegjësitë dhe autorizimet përcaktohen individualisht në përputhje me ligjin.

Drejtori, anëtarët e bordit drejtuesi dhe anëtarët e bordit mbikëqyrës, nëse zbatojnë, gjegjësisht marrin një vendim për të cilin ata e dinin ose, duke pasur parasysh rrethanat, ata duhej të dinin se po dëmtojnë interesat e ndërmarrjes publike, janë përgjegjës në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për dëmin e shkaktuar nga ai vendim . Përgjegjësia përcaktohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare që i referohen organeve drejtuese.

Neni 24-a rregullon arsyet e shkarkimit të drejtorit para skadimit të mandatit të tij.³

³ Neni 24-a. Drejtori i ndërmarrjes publike pushohet nga puna para skadimit të mandatit, në këto raste: (1) me kërkesë të tij, (2) nëse lind ndonjë prej arsyeve, për shkak të të cilave sipas rregulloreve për marrëdhëniet e punës punësimi i tij përfundon në përputhje me ligjin, (3) nëse nuk punon dhe vepron

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit për ndërmarrjet publike, për mbikëqyrjen e veprimeve materiale dhe financiare të ndërmarrjes publike, krijohet një bord mbikëqyrës për kontrollin e veprimeve materiale dhe financiare prej pesë anëtarëve. Mandati i anëtarëve të bordit mbikëqyrës nuk mund të kalojë katër vjet. Anëtarët e bordit mbikëqyrës i emëron, d.m.th. largon themeluesi i ndërmarrjes publike. Anëtarë të bordit mbikëqyrës mund të emërohen persona me arsim të lartë, të cilët kanë njohuri dhe përvojë posaçërisht nga veprimtaria e operacioneve financiare dhe kontabël .

Neni 27 rregullon më në detaje dhe më saktë procedurat për kryerjen e mbikëqyrjes nga bordi mbikëqyrës⁴.

Me interes të veçantë është dispozita e nenit 30 të Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit themeluesi investon fondet e tepërta të realizuara nga funksionimi i ndërmarrjes publike në ndërmarrjen publike, në bazë të planeve të hollësishme financiare.

në përputhje me ligjin, statutin dhe aktet e ndërmarrjes publike ose në mënyrë të pajustificueshme nuk zbaton vendimet e bordit udhëheqës ose drejtues ose vepron në kundërshtim me to; (4) nëse me punën e tij të pakujdesshme dhe të joligjore i ka shkaktuar dëm ndërmarrjes publike; (5) nëse neglizhon ose nuk i kryen detyrimet dhe kështu do të ketë mosplotësim në kryerjen e veprimtarisë me interes publik të ndërmarrjes publike; (6) nëse ai nuk paraqet raport në përputhje me nenin 23-paragrafi 1 të këtij Ligji dhe (7) nëse edhe pas skadimit të afatit të përcaktuar në nenin 23-paragrafi 3 të këtij ligji, ai nuk i heq ato ose edhe në atë afat ose periudhë sërish ka mangësi dhe/ose humbje në punën financiare.

⁴ Neni 27: Për të kryer aktivitetet e kontrollit, bordi i kontrollit mbikëqyrës mund të kryejë e revidim në vend të të gjitha dokumenteve dhe procesverbaleve të ndërmarrjes publike. Bordi i kontrollit mbikëqyrës, për shkak të shqyrtimit ose revidimit të dokumenteve dhe procesverbaleve të ndërmarrjes publike, mund të ftojë ekspertë që ta ndihmojnë atë në zgjidhjen e mbikëqyrjes. Anëtarët e bordit mbikëqyrës për kontroll mund të marrin pjesë në seancën e bordit drejtues/udhëheqës dhe u dërgohet një ftesë me të gjitha materialet që u dërgohen anëtarëve të bordit udhëheqës. Bordi mbikëqyrës i kontrollit duhet të rishikojë llogaritë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike dhe, pas rishikimit, t'i japë një mendim bordit drejtues. Bordi drejtues nuk mund të miratojë llogaritë vjetore dhe raportin për punën së ndërmarrjes publike, nëse nuk ka marrë më parë një mendim pozitiv nga Bordi Mbikëqyrës për Kontroll. Raporti për rishikimin e llogarive vjetore dhe raporti për funksionimin e ndërmarrjes publike me mendimin e tij, Bordi Mbikëqyrës për Kontroll ia dorëzon Ministrit të Financave. Në raportin drejtuar Ministrit të Financave, Bordi Mbikëqyrës i Kontrollit e informon atë për gjendjen e ndërmarrjes publike, funksionimin e së cilës e kontrollon. Bordi Mbikëqyrës i Kontrollit gjithashtu i paraqet një kopje të raportit Ministrit përgjegjës për punët e veprimtarisë përkatëse. Bordi Mbikëqyrës duhet të takohet të paktën katër herë në vit.

Mekanizmi i kontrollit në përputhje me LVL: Marrja e masave për sigurimin e kushteve për funksionimin e papengesë të ndërmarrjes publike

Në përputhje me nenin 38, dhe në rast të shkeljes së punës, përkatësisht kryerjes së veprimtarisë së ndërmarrjes publike ose nëse ndërmarrja publike nuk i kryen detyrimet e përcaktuara me ligj, gjë që nuk është pasojë e moskryerjes së detyrimeve nga themeluesi i përcaktuar me aktin themelues, themeluesi mund të marrë masa që sigurojnë kushte për funksionimin e papengesë të ndërmarrjes publike.

Çrregullimi i funksionimit të ndërmarrjes publike, në përputhje me nenin 39 të Ligjit për ndërmarrjet publike, konsiderohet se ka ndodhur:

- Nëse mënyra e funksionimit të ndërmarrjes publike nuk siguron kryerje të përhershme dhe të pandërprerë të prodhimit dhe qarkullimit të produkteve të caktuara dhe ofrimit të shërbimeve, apo realizimin e planit të zhvillimit, në një mënyrë të përcaktuar me ligj, e cila shkakton dëme ose mund të shkaktohet dëmitim i shfrytëzuesit;
- Nëse me disponueshmërinë e fondeve ndryshon qëllimi themelor i fondeve, ndryshojnë edhe kushtet themelore të funksionimit të ndërmarrjes publike të përcaktuara në përputhje me ligjin, me qëllim të arritjes së interesit publik në ndërmarrjen publike, gjë që në thelb vështirëson kryerjen e veprimtarisë së saj të përcaktuar me akt themelimi dhe
- Në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

Në nenin 40 të këtij Ligji parashikohen pasojat nëse ndërpritet funksionimi ose puna e ndërmarrjes publike. Në përputhje me nenin 40, në rastet e përcaktuara në nenin 39 të Ligjit, ndaj ndërmarrjes publike, themeluesi mund të marrë masat e mëposhtme:

- Të shkarkojë bordin drejtues;
- Të pushojë bordin e kontrollit;
- Të ndryshojë organizimin e ndërmarrjes publike;

-
- Të ndalojë zbatimin e aktit të ndërmarrjes publike i cili është në kundërshtim me ligjin;
 - Të ndalojë zbatimin e aktit të ndërmarrjes publike nëse vë në dyshim kryerjen e funksioneve themelore të ndërmarrjes publike dhe
 - Masat e tjera të përcaktuara me ligjin e veçantë që rregullojnë kushtet dhe mënyrën e kryerjes së një veprimtarie të caktuar me interes publik.

Në rast se themeluesi vepron në përputhje me nenin 40 pika 2 të Ligjit për ndërmarrjet publike, atëherë themeluesi ia transferon kompetencat e bordit drejtues një ose më shumë përfaqësuesëve të cilët emrohen me mandat më së shumti deri në gjashtë muaj.

3. Modalitetet për lidhjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile me Këshillin Komunal, gjegjësisht Qytetin e Shkupit si organ përfaqësues i qytetarëve

Në vazhdim të këtij Udhëzuesi, ne do t'i referohemi modeleve që mund të jenë të dobishme për lidhjen e qytetarëve me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në këshillat në komuna, dmth në Këshillin e qytetit të Shkupit. Këto janë modalitete të përfshira në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe të cilat mund të inkurajojnë dhe mbështesin aktivizmin qytetar për qëllime, tema dhe projekte të ndryshme. Sigurisht, këto modalitete gjithashtu mund të jenë të dobishme në fushën e kryerjes së veprimtarive lokale me interes publik përmes aktiviteteve të ndërmarrjeve publike lokale. Përkatësisht, këto modalitete janë me dobi të veçantë përmes të cilëve qytetarët mund të shprehin nevojat e tyre për një aktivitet të caktuar publik dhe / ose shërbim publik, i cili sërish përmes kompetencave ligjore të këshillave komunalë, pra Këshilli i qytetit të Shkupit, do të zbatohet.

Neni 25 i Ligjit për vetëqeverisje lokale përcakton format e pjesëmarrjes qytetare në proceset e vendimmarrjes. Qytetarët marrin pjesë drejtpërdrejt në vendimmarrjen për çështje me rëndësi lokale përmes iniciativës qytetare, tubimeve të qytetarëve dhe referendumit, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me ligj. Kostot e realizimit të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje bien mbi buxhetin komunal.

- MODALITETI 1: Në bazë të nenit 26 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, *qytetarë kanë të drejtë t'i propozojnë Këshillit të miratojë një akt të caktuar ose të zgjidhë një çështje të caktuar në kompetencën e tij.* Një iniciativë qytetare nuk mund të paraqitet për çështje kadrovike dhe financiare. Këshilli është i detyruar të diskutojë propozimin nëse mbështetet nga të paktën 10% e votuesve të komunës, përkatësisht vetëqeverisja vendore të cilës i referohet çështja e parashtuar.

- MODALITETI 2: Neni 27 i Ligjit për vetëqeverisje lokale rregullon konceptin e "tubimit të qytetarëve". Tubimi i qytetarëve mund të mbledhet për territorin e tërë komunës ose për territorin e vetëqeverisjes vendore. Tubimi i qytetarëve thirret nga kryetari i komunës me iniciativën e tij, me kërkesë të Këshillit ose me kërkesë të të paktën 10% të votuesve të komunës, përkatësisht vetëqeverisjes lokale të cilës i referohet çështja specifike. Brenda 90 ditësh, organet komunale janë të detyruara të rishikojnë konkluzionet e miratuara në tubimin e qytetarëve dhe t'i marrin parasysh ato kur të vendosin dhe të marrin masa për çështjet për të cilat i referohen, si dhe të informojnë qytetarët për vendimet e tyre.
- MODALITETI 3: Një formë e veçantë e pjesëmarrjes qytetare është referendumi lokal. Në pajtim me nenin 28 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, qytetarët mund të vendosin në referendum për çështje që janë në kompetencën e komunës, si dhe për çështje të tjera me rëndësi lokale.
- MODALITETI 4: Aktivizmi civil/qytetar në përputhje me nenin 29 të Ligjit për vetëqeverisje lokale arrihet *përmes të drejtës për ankesa dhe propozime*. Përkatësisht, në përputhje me nenin 29 paragrafi (1) të Ligjit për vetëqeverisje lokale, çdo qytetar ka të drejtë, individualisht ose së bashku me të tjerët, të paraqesë ankesa dhe propozime për punën e organeve komunale dhe administratës komunale. Kryetari i Komunës është i detyruar: të krijojë kushte për paraqitjen e ankesave dhe propozimeve; më së voni 60 ditë, nga dita e pranimit të ankesës, pra propozim, t'i paraqesë përgjigje të arsyeshme parashtruesit dhe ankesat dhe propozimet që nuk i referohen çështjeve nën kompetencat e organeve komunale t'i dorëzoj deri te organi përkatës dhe për të njëjtën ta njoftoj parashtruesin.
- MODALITETI 5: Neni 30 i Ligjit për vetëqeverisje lokale rregullon çështjen e aktivizmit civil përmes debateve publike, anketave dhe propozimeve . Përkatësisht, gjatë përgatitjes së rregulloreve të komunës, Këshilli, përkatësisht kryetari mund të organizojë më parë tribuna publike, të kryejë sondazhe ose të kërkojë propozime nga qytetarët.

-
- MODALITETI 6: Një koncept i veçantë i pjesëmarrjes së qytetarëve në praktikën e qeverisjes lokale është *koncepti i vetëqeverisjes vendore*. Në përputhje me nenin 82 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, në komunë mund të formohen forma të vetëqeverisjes vendore, si vijon: në qytete bashkësi urbane dhe në vendbanime të tjera bashkësi lokale. Statuti i komunës përcakton më hollësisht: (1) format e vetëqeverisjes vendore që janë të vendosura në territorin e komunës; (2) marrëdhëniet me organet komunale; (3) punët nën kompetencat e kryetarit të komunës kryerja e të cilëve mund t'i delegohen kryetarit të këshillit të vetëqeverisjes vendore; (4) mënyrën e sigurimit të fondeve për punët e deleguara dhe (5) çështje të tjera me rëndësi për vetëqeverisje lokale. Neni 83 i Ligjit për vetëqeverisje lokale përcakton kompetencat e formave të vetëqeverisjes vendore. Përkatësisht, banorët, në bashkësitë urbane, gjegjësisht bashkësitë vendore, në tubimet e qytetarëve: (1) shqyrtojnë çështje, (2) marrin qëndrime dhe përgatisin propozime për çështjet me rëndësi të menjëhershme dhe të përditshme për jetën dhe punën e banorëve të asaj zone; (3) ata mund të zgjedhin një këshill të bashkësisë urbane, gjegjësisht bashkësisë vendore, në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me statutin e komunës. Gjithashtu, në përputhje me nenin 86 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, kryetari i bashkisë mund të delegojë detyra të caktuara me interes të menjëhershëm dhe rëndësi ditore për jetën dhe punën e banorëve kryetarit të këshillit të bashkësisë urbane ose vendore, në mënyrë të përcaktuar me statut.